

AKT-THEMELIM
I
SHOQËRISË

AGRO KOLDASHI sh.p.k.

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901,dt. 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”,
UNE, :

I. Gazmen Koldashi i biri i Halil -it i datelindjes.10/09/1971 lindur dhe banues ne
Ujmisht i paisur me leternjoftim me nr H10910048Q

Sot me dt. 12/02/2021, me vullnetin tim të lirë dhe të plotë, vendosa të hartojë këtë **Akt-
Themelimi** për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

AGRO KOLDASHI sh.p.k. si

ORTAKET.

Akti i Themelimit hartohet me këto kushte:

Neni 1

Ortaku **Gazmen Koldashi** me gjeneralitetet e mësipërme, me vullnet të lirë dhe të plotë
krijoj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar **AGRO KOLDASHI** sh.p.k. .

Neni 2

Shoqëria vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon mënyrën e
organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare dhe në përputhje me dispozitat e Statutit që i
bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi.

Neni 3

Emri i plotë i shoqërisë është **AGRO KOLDASHI** sh.p.k. .

Neni 4

1. Selia e shoqërisë është në , **Lagjja Nr.2, Rruga Gora , Zona Kadastrale
Nr.2315. Nr. Pasurie 50/240, Kati Bodrum**

„Sipas dispozitave të përcaktuara në Statut dhe në Akt – Themelimit, veprimtaria e shoqërisë do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj, duke krijuar filialet apo degët e saj.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **AGRO KOLDASHI** sh.p.k. do të jetë ai i përcaktuar në Statutin e Shoqërisë :

Blerje dhe shitje te bimeve medicionale.Import –Eksport.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë **100.000 (njëqind mijë) leke** ndare ne 1 kuota . Kapitali themeltar mund të rritet sipas dëshirës së ortakut dhe kushteve në të cilat ushtron veprimtarinë, në formën dhe mënyrën e parashikuar në Statut.

Neni 7

Administrator i Shoqërisë do të jetë **Z.Gazmen Koldashi** . Kompetencat e tij përcaktohen në Statut.

Neni 8

Viti financiar i Shoqërisë mbyllet me 31 Dhjetor, ora 24^{oo} te çdo viti kalendarik. Bilanci vjetor i veprimtarisë së shoqërisë përfundohet brenda muajit Mars të vitit të pasardhës.

Neni 9

Shoqëria gëzon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka të drejtë ti përdorë ato në përputhje me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 10

Ky Akt–Themelim do të jetë efektiv nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

Për SHOQERINE
AGRO KOLDASHI shpk

ADMINISTRATORI
Gazmen Koldashi


Ortaku
Gazmen Koldashi

